



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 08.05.2026

Lenda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj, Instituti i Sigurimeve Shoqërore vlerëson insiciativën e Televizionit MCN për trajtimin e problematikave që lidhen me njohjen dhe konfirmimin e viteve të sigurimit për efekt të përfitimeve të personave që kanë periudha punësimi në subjekte paguese.

Në drejtim të administrimit të listëpagesave të veprimtarive ekonomike, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka trajtuar me seriozitet problemin e mungesave të listëpagesave në formatin letër, për periudhat kohore 2005 – 2012.

Konkretisht, **në përgjigje të pyetjes 1** “Sa është numri i listëpagesave që mungojnë dhe për cilat vite”, **ju informojmë se:**

ISSH ka mungesë të listëpagesave të formatit letër, që i përkasin periudhës deri më datë **31.12.2011.**

Më datë 01.01.2012 çdo listëpagesë e paguar nga subjekti, paraqitet në formatin elektronik të të dhënave.

Situata e mungesave të listëpagesave **deri më datë 31.12.2025**, paraqitet si më poshtë:

Subjektet Publike (Buxhetorë dhe Jo Buxhetorë)	3,907	–	0.27%	e totalit të mungesave
Biznes i Madh Privat	69,439	–	4.75%	e totalit të mungesave
Biznes i Vogël	1,396,235	–	95%	e totalit të mungesave
Gjithsej	1,469,581			

Në leximin e të dhënave të mësipërme vlen të theksohet se për rajonin e Tiranës nuk ka përfunduar akoma procesi i sistemit të të dhënave të ardhura nga DPT lidhur me pagesat e të vetëpunësuarve të vetëm, çka do të thotë se të dhënat e mungesave për listëpagesat e subjekteve fizike në rajonin Tiranë nuk janë të dhëna përfundimtare.

Të dhënat e mungesave të listëpagesave të formatit letër për periudhën 2005 – 2012, pa përfshirë të dhënat e Biznesit të Vogël Tiranë (të cilat janë në përpunim e sipër), paraqiten si më poshtë:

Listëpagesa gjithsej 242,324, nga këto:

- **3,907 janë mungesa në subjektet Publike (Buxhetorë dhe JoBuxhetorë),**
- **69,439 janë mungesa në subjektet Biznes i Madh Privat,**
- **168,978 janë mungesa në subjektet e Biznesit të Vogël.**

Procesi i grumbullimit të listëpagesave të munguara në arkivin e ISSH, është në ndjekje të vazhdueshme, punohet çdo ditë në bashkëpunim dhe me strukturën e DPT, deri në plotësim të fondit arkivor të munguar.

Në përgjigje të pyetjes 2 “*A rrezikojne qytetarët të humbasin vite pune dhe të penalizohen në pension*”, sqarojmë se:

Në mbështetje të neneve 13 pika 3, 15, 58 dhe 91, pika 3, të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga data 01.01.1994 e në vazhdim, konsiderohet periudhë sigurimi vetëm periudhat për të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore, periudha të cilat konfirmohen vetëm nëpërmjet dokumenteve: “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Mandat pagesa” përkatëse.

Në rast se konstatohet se, listëpagesat e subjekteve mungojnë apo nuk janë dorëzuar në arkivin qendror të ISSH, zbatohet procedurën si vijon: Informohet qytetari për mungesën e dokumentacionit dhe mundësinë për të plotësuar këtë mungesë duke e rifreskuar dokumentacionin, listëpagesë sipas formatit të kohës dhe mandatpagesë, të cilat dërgohen për konfirmim në organet tatimore. Pas konfirmimit të saktësisë dhe vlerësimit të shumave të paguara nga organet tatimore, listëpagesat dorëzohen në arkivin qendror të ISSH, i cili më pas plotëson vërtetimin për periudhat kontributive të paguara për individë të caktuar.

Në përgjigje të pyetjes 3 “*Sa persona janë prekur konkretisht nga gabimet në numrin personal?*”, sqarojmë se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk mund të identifikojë numrin e personave të punësuar për të cilët subjektet paguese nuk e kanë vendosur Numrin Personal të personit të punësuar në përputhje me të dhënat përkatëse të Kartës së Identitetit.

Në çdo rast evidentimi të kësaj problematike, është subjekti deklarues, i cili duhet të bëjë korrigjimin e listëpagesës, e cila kontrollohet nga organet tatimore dhe më pas përcillet në ISSH.

Në përgjigje të pyetjes 4 “*Pse nuk është zgjidhur ende problemi midis ISSH dhe DPT prej vitit 2017?*”, sqarojmë se:

Problematikat e hasura gjatë procedurave ditore, lidhur me listëpagesat e munguara, pagesat e kontributeve, gabimet në elementin NID etj..., ndiqen me rigorozitet nga të dyja institucionet ISSH dhe DPT në vijimësi, për ti dhënë zgjidhje çdo shtatë të kësaj në vite.

Në përgjigje të pyetjes 5 “*Kush mban përgjegjësi për mungesën e listëpagesave për më shumë se një dekadë?*”, sqarojmë se:

Procedurat e rregullave të marrjes në dorëzim të listëpagesave të formatit letër nga organet tatimore në sigurimet shoqërore, kryhen në mbështetje të bazës ligjore:

- Ligji Nr. 9136, datë 11.09.2003, i ndryshuar, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”,

- VKM Nr. 1114, datë 30.07.2008, “Disa çështje, në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9136, date 11.9.2003,

“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,

- Udhëzimi Nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”,
- Udhëzimi Nr. 23, datë 09.12.2014 i Ministrisë të Financave, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”,
- VKM Nr. 77 datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, i ndryshuar,
- Akt Marrëveshja e Bashkëpunimit, ndërmjet DPT dhe ISSH, Nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe Nr.11422, datë 19.05.2017.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktimet e nenit 3 “Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme”,

“Kontributet mbledhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, të nenit 7 “Regjistrimi i të punësuarve në organin tatimor”:

“Personat juridikë ose fizikë, brenda dy ditëve pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, deklarojnë në organin tatimor listën e të punësuarve, pagën përkatëse, përfshirë për personin fizik edhe punonjësit e papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht”, si dhe të nenit 16 “Kontrolli i organeve tatimore” ku përcaktohet se:

“1. Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta.

2. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbështetje të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Në përgjigje të pyetjes 6 “A është vendosur një afat përfundimtar kur do plotësohen të dhënat e munguara?”, sqarojmë se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Degët e Kontributeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë ndërtuar Plan Veprimi për evidentimin dhe njoftimin e subjekteve paguese.

Në fokus të këtij Plan - Veprimi kanë qenë inventarizimi dhe ri-inventarizimet fizike në shkallë vendi të listëpagesave për të katër llojet e biznesit (Buxhetorë, Jobbuxhetorë, Biznes i Madh Privat dhe Biznes i Vogël) dhe dërgimi zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore (prej shtatorit 2014 e në vazhdim), i listës së subjekteve me mungesa të listëpagesave sipas muajve, viteve përkatëse dhe llojit të biznesit për periudhën kohore 2005 – 2012.

Procedura e grumbullimit të listëpagesave të munguara pranë arkivit qendror të ISSH vijon të kryhet çdo ditë.

Në përgjigje të pyetjes 7 “Pse sistemi CMIS nuk pasqyron rastet e gjyqfituesve?” dhe pyetjes 9 “Pse sektori i arsimit rezulton me problematikë?”, sqarojmë se:

Ligji Nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Nenin 10 “Detyrimi për të deklaruar”, ka përcaktuar se:

“1. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ.

*2. Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë, në formë elektronike, në organin tatimor, të dhënat e detyrimeve për kontributet, sipas deklaratës përkatëse, **ku, përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t’u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.***

3. Forma, përmbajtja dhe rregullat e deklarimit, në organet tatimore, të kontributeve dhe ndryshimit të numrit të punonjësve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave”.

Për kryerjen e procedurave përkatëse, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka miratuar Udhëzimin Teknik “Rregullat për deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe TAP, të periudhave tatimore të mëparshme” (dokument i cili është i publikuar në adresën elektronike “tatime.gov.al”.

Në këtë drejtim, subjektet paguese, si në rastin e personave gjyqfitues ashtu dhe në rastin e personave të punësuar në Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të cilët nuk janë vendosur të dhënat e plota sipas rubrikave që përmban listëpagesa duhet të respektojnë procedurat e përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe udhëzimet teknike të sipërcituara.

Për çdo rast të evidentuar, janë orientuar subjektet të kryejnë procedurat sipas rregullave të përcaktuara.

Në përgjigje të pyetjes 8 “Pse pagesat pjesore nuk rezultojnë në sistem CMIS?”, sqarojmë se:

Udhëzimi Nr. 23, datë 09.12.2014 i Ministrit të Financave, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 10.10 të Kapitullit 10 “Të tjera”, ka përcaktuar se:

*“Të dhënat e rubrikave të Deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, nga Drejtoria Rajonale Tatimore **dërgohen në formë elektronike, në organet e Sigurimeve Shoqërore dhe ato të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, vetëm pasi ato të jenë likuiduar plotësisht nga tatimpaguesi përkatës për shumën totale të detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të periudhës tatimore përkatëse.** Listëpagesat e palikujduara plotësisht nga tatimpaguesi administrohen në Drejtorinë Rajonale Tatimore deri sa të kryhet pagesa e plotë e shumës së kontributeve që ato përmbajnë”.*

Bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor rregullues në fuqi si dhe Dokumentit “Protokolli i Komunikimit Elektronik të Listëpagesave” sqarojmë se konfigurimi i sistemit të protokollit të raportimit përcakton raportimin e të dhënave në nivel NIPTI – Listëpagese dhe jo NID – Personi.

Në përgjigje të pyetjes 10 “*Sa i besueshem është sistemi i llogaritjes se pensioneve?*”, sqarojmë se:

Sistemi i llogaritjes së pensioneve, është i saktë, llogaritja kryhet me program të vecantë, ku llogariten të dhënat e detajuara për periudhat e punës dhe kontributet e paguara gjatë historikut individual të çdo kontributpaguesi.

Në përgjigje të pyetjes 11 “*A garanton ISSH sot që çdo qytetar i ka kontributet e sakta?*”, sqarojmë se:

Ligji Nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Nenin 16 “Kontrolli i organeve tatimore” ka parashikuar që:

“1. Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta.

2. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjithashtu, Neni 18 “Vlerësimi”, i këtij ligji përcakton se:

“Kur organet tatimore zbulojnë se kontributet nuk janë llogaritur në masën e duhur, bëjnë vlerësime. Për vlerësimet, mbledhjen e detyrimeve për kontributet, kamatëvonesat e gjobat, si dhe radhën e pagesës së tyre, zbatohen rregullat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar afatin e parashkrimit të detyrimeve.”

Në interpretim të përcaktimeve ligjore të sipërcituara, sqarojmë se kontributet e sigurimeve shoqërore që administrohen në Fondin e Sigurimeve Shoqërore janë kontribute të sakta, në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat përkatëse të llogaritjes, përpunimit dhe transferimit të këtyre kontributeve në llogarinë e sigurimeve shoqërore, të cilat pasqyrohen në historikun individual të çdo kontributpaguesi.

Gjithashtu Ju njoftojmë se subjekti:

- Subjekti Tema TV (emri i subjektit në listëpagesë deri në Qershor 2020), me NIPT L42404004O, i cili në administratën tatimore rezulton në vijim me emrin “MCN 24” figuron me 42 periudha të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- Subjekti “JOHANITERI” me NIPT K52108501I. Ky subjekt është me detyrime të papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat, Shkurt 2024, Gusht 2024, dhe Mars 2025 e në vazhdim.

Detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore, sjellin vonesa të konsiderueshme në krijimin e një historiku të plotë kontributiv individual për çdo kontributpagues duke krijuar

pasoja në drejtim të procedurave që kërkohen për miratimin e përfitimeve si, leje barrë lindje, raporte afatshkurtra apo caktimin e pensioneve.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ***Subjekti ka Detyrimin për të deklaruar dhe paguar kontributet për çdo periudhë dhe për çdo individ të punësuar.***

Në mbështetje të neneve 13 pika 3, 15, 58 dhe 91, pika 3, të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nga data 01.01.1994 e në vazhdim, ***konsiderohet periudhë sigurimi vetëm periudhat për të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore,*** periudha të cilat konfirmohen vetëm nëpërmjet dokumenteve: “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Mandat pagesa” përkatëse të pasqyruara në sistemet elektronike të DPT dhe ISSH.

Faleminderit për bashkëpunimin !